



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna Drenas (Gllogoc)
Kuvendi Komunal



02 Nr 400/01-31025 dt. 29.06 2023

Bazuar në nenin 11, 12, dhe 40, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në bazë të nenit 5 nënparagrafi 1.2 pika 1.2.3, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 17 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.01/2018 për Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme, Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor. Kuvendi i Komunës së Drenasit/Gllogocit në mbledhjen e rregullt e mbajtur me datë, **29.06.2023**, miratoi këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR QENDRËN E
QYTETIT-GLLOGOC

Neni 1

Miratohet vendimi i Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit-Gllogoc.

Neni 2

Planet Rregulluese të Hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave për zona urbane apo rurale, siç është përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale Komunale.

Neni 3

Zona për të cilën do të hartohet Plani Rregullues i Hollësishëm është Qendra e Qytetit- Gllogoc dhe përfshinë një sipërfaqe prej S=110.00 Ha.

Neni 4

Plani Rregullues i Hollësishëm mbulon një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

Neni 5

Autoriteti për planifikim hapësinor është përgjegjës për zbatimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në bashkërendim dhe bashkëpunim me autoritetet tjera përkatëse sektoriale përgjegjëse.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Plani i dërgohet:
Vendimi i dërgohet:
Zyrës së Kryetarit ;
Drejtorisë Përkatëse;
Zyrës së Kuvendit;
Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Milaim Hajdari

ARSYETIM

Me miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Glogocit për periudhën 2022-2030 të datës 24.06.2022, Komuna e Glogocit është përcaktuar që përmes Hartës Zonale të Komunës të identifikojë zonat për të cilën kërkohet të hartohet Planit Rregullues i Hollësishëm, me vendim të kuvendit të komunës 02-Nr.030/01-46344 datë 31.08.2022, është filluar me hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Glogoc për të përcaktuar kushtet për rregullimin e hapësirave për zonën urbane.

Me Vendimin 02-Nr.400/01-14932 datë 28.03.2023 të kuvendit të komunës, është miratuar vendimi për lënie në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Glogoc, në mënyrë që t'u lihet në dispozicion qytetarëve, agjencive, departamenteve dhe organeve të tjera për shqyrtim dhe komente për projekt dokumentin Planit Rregullues i Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Glogoc.

Shqyrtimi publik i Projekt dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit- Glogoc ka zgjat 30 ditë, sipas procedurave të përcaktuara me ligj. Pas përfundimit të kohëzgjatjes së shqyrtimit publik, projekt dokumenti së bashku me përmbledhje të shkurtër të komenteve të bëra gjatë diskutimit publik- raportin, do t'i dorëzohen kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glogocit Milaim Hajdari, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glogocit
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Trim Berisha, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit Shendrita Latifi Praktikante në Departamentin Ligjor
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë
Lloji i aktit:	Vendimin 02Nr.400/01-31025 për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit të Glogocit, miratuar nga Kuvendi Komunal i Glogocit

I nderuar Kryetar Lladrovci,
I nderuar Kryesues Hajdari,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, ka pranuar nga MAPL Vendimin 02Nr.400/01-31025 për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit të Glogocit, miratuar nga Kuvendi Komunal i Glogocit, datë 03.06.2023.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, kërkon nga Kuvendi i Komunës së Glogocit:

K O N F I R M O N

Vendimin 02Nr.400/01-31025 për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit të Glllogocit, miratuar nga Kuvendi Komunal i Glllogocit.

A r s y e t i m i

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të Vendimit 02Nr.400/01-31025 për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Qendrën e Qytetit të Glllogocit, miratuar nga Kuvendi Komunal i Glllogocit, nuk është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe akteve nënligjore në fuqi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, mbetet në dispozicion të Komunës së Glllogocit dhe MAPL-së, për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

